**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-26-3512-5-1-1/C1156**
**14 Nr. 550/26**
**Dt. 24.06.2026**

KONTRATË PUNE

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson **z. Ilmi Azemi** - Drejtor i Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI)** , dhe

2. **Grupi i O.E. : " Asfalt Corp. "sh.p.k., emri i biznesit/" Asfalt Corp "emri tregtar, me ARBK: 811915802, me seli në Ferizaj** & " Famis CO-HC " sh.a. , emri i biznesit, me ARBK : 810628399, me seli në Suharekë & " EL-BAU "sh.p.k., emri i biznesit, me ARBK : 811182576, seli në Gjilan, të cilët i përfaqëson **z. Visar Qorolli** , në tekstin e mëtejmë: KRYESI I PUNËVE

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë: **" Rregullimi i lumit Silnica nga shkarkimi i lumit Podranqa deri te shkarkimi i lumit në fshatin Smrekonicë " ashtu sikurse është saktësuar dhe specifikaur në dokumentin Përshkrimi i Pozicioneve dhe Çmimet, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderi dhe e kësaj Kontrate** , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Prokurimit | VU644 | 2 | 6 | 35 | 1 | 2 | 5 | 1 | 1 |
| Nr. i brendshëm | VU644 | 2 | 6 | 0 | 0 | 9-1 | 5 | 1 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit dhe ka të bëjë me sa vijon :

- **rregullimin e shtratit të lumit Silnica, pasi që brigjet e lumit në fjalë janë deformuar duke pësuar devijime në disa pika. Në këtë projekt është paraparë edhe rregullimi i shtratit minor me gurë të radhitur dhe te shtanguar me traje të betonit. Shtrati major përdoret edhe për te mbjella për banoret e zonës pasi qe rrjedha e lumit ne shumicën e vitit rrjedh vetëm në shtratin minor ose ne gjysmën e shtratit minor e tëra kjo**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me : **Nr. i prokurimit : VU644-26 – 3512-511 dhe Nr. i Brendshëm : VU644-26-009/1-511**
- **Afati i fillimit të punimeve është** 5 ( pesë ) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.

1.2 Afati i përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas afatit të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, jo më gjatë se **30 Tetor 2028** nga data e fillimit të punimeve. **( projekt tre vjeçar 2026 – 2028).**

1.3 Kryesi i punimeve ka të drejtë të kërkoi shtyrjen e afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

1.4 Punëdhënësi, menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, do të emëroi Menaxherin e Kontratës/Projektit si dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës duke i përcaktuar edhe përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me realizimin e kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e punimeve sipas projektit.

1.5 Punëmarrësi obligohet që, në kërkesë me shkrim të Punëdhënësit apo organit të autorizuar prej tij, të kryej edhe punë tjera shtesë të paparapara lidhur me projektin në fjalë, por që nuk do të filloi me punimet shtesë përderisa me Punëdhënësin nuk arrihet marrëveshje- aneks kontratë me shkrim për të specifikuar punët dhe çmimin e punëve shtesë.

1.6 Vetëm Autoriteti Kontraktues mundë ti miratoi ndryshimet, modifikimet, shmangiet dhe zëvendësimet në Përshkrimin e Punës, në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së në fuqi që rregullojnë këto çështje.

1.7 Punëmarrësi do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të pajustifikuar të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

1.8 Punëmarrësi, pas përfundimit të procedurave të pranimit teknik të përkohshëm të punimeve, përmes **afatit garantues i cili nuk mundë të jetë më i shkurtë se 1 ( një ) vit** , e siguron Punëdhënësin se punët dhe detyrat e besuara janë kryer me një cilësi të lartë dhe sipas konditave të përcaktuara me projekt dhe sipas dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ( MD-së ) që rregullojnë këtë çështje.

1.9 Garantimi i cilësisë së punëve nga ana e Punëmarrësit do të bëhet në afatin dhe në institucionin e përcaktuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit.

1.10 Afati garantues fillon nga dita e pranimit teknik të përkohshëm të objektit.

1.11 Punëmarrësi obligohet që, brenda afatit kohorë garantues, me ftesë- kërkesë të Punëdhënësit t'i eliminoi, me shpenzime të tija, gjitha të metat eventuale të shfaqura në objekt me fajin e tij dhe atë në afatin prej 5 ditësh
pune nga dita e dërgimit të ftesës.

1.12 Në rast se Punëmarrësi në afatin e paraparë nuk i ndërmerr veprimet për eliminimin e të metave, Punëdhënësi të metat e paraqitura do ti eliminoi përmes angazhimit të një punë kryesi tjetër, e në barrë të Punëmarrësit,
duke shfrytëzuar mjetet financiare të depozituara me Garancion të Sigurimit të Cilësisë.

1.13 Punëmarrësi nuk do të përgjigjet për të metat e shfaqura si pasojë e shfrytëzimit – përdorimit jo adekuat të objektit të pranuar. Me këtë rast për bazë do të mirën dispozitat e LDM-së që rregullojnë këtë çështje.

1.14 Gjatë kryerjes së punimeve do të udhëhiqet libri ndërtimorë dhe ditari i punës sipas normave ligjore në fuqi, ndërsa Punëdhënësi apo organi i autorizuar prej tij do ti vërtetoi punimet e kryera sipas dinamikës, konformë
specifikimit në para masë , para llogari dhe planin dinamik të punëve.

**Neni 2 Çmimi**

**2.1** Çmimi total i punëve duhet të jetë: **2,651.127,59€ ( dymiliongjashqindpesdhjetenjëmijnjëqindnjëzeteshtat/59Euro).**

**2.2** Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

**2.3 Ashtu sikurse është rregulluar edhe me dispozita të Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e dosjes së tenderit, duke qenë se projekti si në nenin një të kësaj kontrate është projekt afatgjatë ( trevjeçarë) ndërkaq, realizimi në tërësi i projektit nxitë ngritjen e obligimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit – Komunës së Vushtrrisë, që duhen përmbushur nga përvetësimet e viteve të ardhshme fiskale 2027 dhe 2028, bazuar dhe në Planifikimin buxhetor të Komunës së Vushtrrisë për vitet në vijim, palët kontraktuese pajtohen që dinamika e realizimit të punëve në projektin në fjalë të realizohet në harmoni me dinamikën e përvetësimeve të mjeteve financiare sipas viteve, në pajtim me pjesën e lëndës së kontratës – pjesë e dosjes së tenderit me Nr. prokurimi : VU644-26 – 53512-511 / Nr. i Brendshëm : VU644-26-009/1-511 , respektivisht dinamika e realizimit**

**të projektit , sipas viteve 2026 , 2027 dhe 2028 do të realizohet sipas shumave dhe afateve, me sa vijon:**

- **në vitin 2026 nga buxheti i A.K. do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 100.000,00€ duke mos përjashtuar mundësinë që AK. të siguroi edhe mjete tjera nga fondi për bashkëfinancim të projekteve dhe / ose mjete nga mjetet e redestinuara nga mbetjet e projekteve të realizuara;**

- **në vitin 2027 do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 1.270,000.00€, ndërsa**

- **në vitin kalendarik 2028 do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 1.281.127,59€**

**2.4** Pagesat financiare do të bëhen : **në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.**

**2.5** Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3 Pranimi teknik i objektit**

**3.1** Pas përfundimit të punimeve Punëmarrësi do të kërkoi pranimin teknik të përkohshëm të objektit të përfunduar, ndërsa Punëdhënësi do të zbatoi procedurat e pranimit teknik të përkohshëm të objektit dhe atë nga momenti kur Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Punëdhënësit e njoftojnë, me shkrim, Punëdhënësin mbi përfundimin e gjitha punëve të parapara.

**3.2** Në pajtim me Kërkesat e saktësuara si ë Kushtet e Veçanta të Kontratës, Punëmarrësi do të depozitoi Sigurimin e Kualitetit të Punëve në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, **për një periudhë garantuese të defekteve prej 13 ( trembëdhjetë ) muajve** nga data e pranimit teknik të përkohshëm në emër të shumës së mbajtje së parasë.

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) Plani për menaxhimin e kontratës;
(g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit
(h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

4.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do ti marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me **nr. prokurimi : VU644 – 26 – 3512 – 5-1-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 26 – 009/1 – 511**

4.4. **Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë Gjykata Komerciale në Prishtinë ( Departamenti për Çështje Ekonomike ), ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në**

**dokumentacionin – Dosjen e Tenderit me nr. prokurimi : VU644 – 26 – 53512 – 5-1-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 26 – 009/1 - 511**

**Neni 5 Komunikimet**

**5.1** Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, e-mail ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues duhen të adresohen tek Autoriteti Kontraktues, Zyrtari Përgjegjës për Prokurim dhe Menaxheri i Projektit i A.K. , i emëruar me vendim të Veçantë nga A.K..

**5.2 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, e-mail ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues duhen të adresohen tek Autoriteti Kontraktues, Zyrtari Përgjegjës për Prokurim dhe Menaxheri i Projektit i A.K. , i emëruar me vendim të Veçantë nga A.K..**

**Menaxheri i kontratës dhe Operatori Ekonomik obligohen që për çdo kërkesë lidhur me punë shtesë, ndryshim të kontratës, vështirësi gjatë realizimit të kontratës apo çfarëdo rrethane që mund të ndikojë në zbatimin e saj dhe në të gjitha komunikimet zyrtare - kontraktuale ta perfshijn në cc: Drejtorin e Prokurimit dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës Vushtrri.**

**Çdo marrëveshje, komunikim, udhëzim apo dakordim ndërmjet Menaxherit të Kontratës dhe Operatorit Ekonomik, i cili nuk është paraprakisht i miratuar dhe i evidentuar nga Drejtoria e Prokurimit dhe Zyra e Kryetarit të Komunës Vushtrri, nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon obligime për Autoritetin Kontraktues.**

5.3 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.4 Çdo marrëveshje, komunikim, udhëzim apo dakordim ndërmjet Menaxherit të Kontratës të A.K. dhe Kontraktuesit i cili nuk është paraprakisht i miratuar dhe evidentuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk prodhon efekt juridik dhe nu krijon obligime për Autoritetin Kontraktues.

5.5 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.6 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

| Për Autoritetin Kontraktues<br>Komuna e Vushtrrisë | | Për Kontraktuesin :<br>**" Asfalt Corp. "sh.p.k.** & " Famis CO-HC"sh.a. & " EL-BAU "sh.p.k. me seli në Ferizaj |
|---|---|---|
| **Emri : Ilmi Azemi** | **Emri : Ferit Idrizi** | **Emri : Visar Qorolli** |
| **Pozita : Drejtor i Prokurimit Publik** | **Pozita : Kryetar i Komunës** | **Pozita : drejtor** |
| **Nënshkrimi:** | **Nënshkrimi:** | **Nënshkrimi:** |
| **Data:** 24.06.2026 | **Data:** 24.06.2026 | **Data:** 26.04.2026 |
| | v.v. | v.v. |

ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

# Deklaratë e Garantuesit

**SIGURIA E EKZEKUTIMIT**

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **151207**

Për **Kuvendi Komunal Vushtrri**
( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **ASFALT Corp. SH.P.K.**
(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operaratori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim**
Nr. prokurimit: 644-26-3512-5-1-1

**Garancion me kërkesë të parë**

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci.
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **265,112.75€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilen deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratëne e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
b. Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **265,112.75€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.
Kjo siguri vlenë 919 ditë kalendarike prej **26.06.2026** deri më **31.12.2028**
Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 24.06.2026
Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG INSURANCE COMPANY

Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

ELSIG
Gjithcka që duhet ta keni
Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112: Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

# POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

*Nr. Polices:* ***151207***

**Kontraktuesi**

| | |
|---|---|
| *Emri* | ASFALT Corp. SH.P.K. |
| *Përfaqësuar nga* | Visar Qorolli |
| *Adresa* | Rruga Qahil Salihu, 34 |
| *Nr i Biznesit* | 811915802 |
| *Telefoni* | 044619612 |

**Përfituesi**

| | |
|---|---|
| *Emri* | Kuvendi Komunal Vushtrri |
| *Adresa* | Vushtrri |

**Garantuesi**

| | |
|---|---|
| *Emri* | Elsig |
| *Banka Garantuesit* | NLB |

**Mbulueshmëria e Polices**

| | |
|---|---|
| *Shuma Siguruar* | 265,112.75 |
| *Periudha Sigurimit* | 26.06.2026 - 31.12.2028 |
| *Primi* | 9,915.25 |
| *Tvsh* | 1,784.74 |
| *Primi Bruto* | 11,699.99 |
| *Data e lëshimit* | 24.06.2026 14:45 |

*Aktiviteti Ekonomik:*
*Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim*

**Lënda e Garancisë**

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësoje çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesi/Garantuesi).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

**Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.**

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions

Kompania e Sigurimeve Elsig
Shkendije Kelmendi Hajdini - 4690

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG INSURANCE COMPANY

Përfaqësuesi i të siguruarit
Visar Qorolli

# PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

| MBAJTËSI I LLOGARISË | |
|---|---|
| Emri | Asfalt Corp shpk |
| Adresa | Ferizaj |
| Qyteti | Ferizaj |
| Kodi Postar | 70000 |
| Kontakti | Visar Qorolli |
| Telefoni | 049/944244 |
| Fax | |
| E-mail | V_qorolli@hotmail.com |
| Numri i TVSH | 330517047 |

| BANKA | |
|---|---|
| Emri | PRIBANKA SH.A |
| Adresa | Lipjan |
| Qyteti | Lipjan |
| Kodi Postar | 14000 |
| Shteti | Kosovë |
| Llogaria Bankare | 241-613-010-017-908-6 |
| IBAN (opionale) | |
| BIC (Opcionale) | |

**SHËNIME:**

| VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI i PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme) | DATA + NËNSHKRIMI i MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme) |
|---|---|
| PriBank SH.A. Dega Lipjan<br>10.06.2026 | 10.06.2026<br>ASFALT Corp. Sh.p.k. SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA FERIZAJ |

\

# REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
# KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 446/26
Dt. 30.06.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtime nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese DKA-së dhe ZPP-së, më **dt. 30.06.2026** merë:

## V E N D I M

Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxheri të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim**, **me numër të prokurimit: VU644-26-3512-5-1-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-26-009-5-1-1**, si vijon :

**z.Mentor Jashari**, emërohet menaxher i kontratës.
**Z.Benjamin Shala** emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :**

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e perfomancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktuesi i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 6l.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si

  menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do ti krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim mes Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do ti lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësive të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me kushtet e Kontratës dhe Porosinë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkoi mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpiloi – lëshoi një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoi Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejmë
- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësive të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

**Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë€ me sa vijon :**

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës
nën mbikëqyrjen e tij.

2. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë Operatorit : **Grupi i O.E. : " Asfalt Corp. "sh.p.k., emri i biznesit/" Asfalt Corp "emri tregtar, me ARBK: 811915802, me seli në Ferizaj & " Famis CO-HC "sh.a., emri i biznesit, me ARBK : 810628399, me seli në Suharekë & "EL-BAU "sh.p.k., emri i biznesit, me ARBK: 811182576, seli në Gjilan, të cilët i përfaqëson z. Visar Qorolli, në tekstin e mëtejmë: KRYESI I PUNËVE,**

Kopje: Menaxheri i Kontratës;
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;
Drejtorisë së Prokurimit;
Drejtorit të Njësisë Kërkuese

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

*Gjithcka që duhet ta keni*

## Deklaratë e Garantuesit

**SIGURIA E TENDERIT**

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **150542**

Për **KOMUNA E VUSHTRRISË**
( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **ASFALT Corp. SH.P.K.**
(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operaratori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rregullimi i Lumit Slinica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim**
Nr. prokurimit: 644-26-3512-5-1-1 , Nr. brendshëm: 644-26-009-5-1-1

**Garancion me kërkesë të parë**

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të tenderit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues,
dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit,
dhe ngase jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci.
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **26,512.83€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilen deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se tenderuesi i ka dhënë informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese autoritetit kontraktues
b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatiti të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të perludhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në dosje të tenderit
c. Tenderuesit iu është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi e refuzon apo dështon:
    - Që të depozitoi sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në dosje të tenderit
    - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në dosjen e tenderit
    - Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit

Pagesa në shumën e limituar prej **26,512.83€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.
Kjo siguri vlenë **150** ditë kalendarike prej **05.06.2026** deri më **02.11.2026**
Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 02.06.2026
Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG INSURANCE COMPANY

Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

KS" ELSIG" Sh.a Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli" nr.3
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~ Ndërsa në kolonën G. duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore**

| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Parallogaritura. Punëkryesi duhet tia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e qualitetit dhe te standardeve. | | | | | | | | | |
| **1** | **PUNËT PËRGATITORE** | | | | | | | | |
| **1.1** | Mobilizimi dhe krijimi I zyrës mobile lëvizëse ( kontinjer ) I cili tëheqet, I cili do të plotësojë kushtët për stafin n ë teren | komplet | 1.00 | 1694.92 | 18.00 | 2000.00 | 1694.92 | 305.08 | 2000.00 |
| **1.2** | Mobilizimi I nderrmarjes per te gjitha aktivitete perfshirë edhe Aktiviteti inxhinjerike dhe makinerit per kete projekt.në këtë pozcion edhe vendosja e kontinjerit mobil për për mengjerin e kontratës me qasje të rregullt dhe komode per stafin e investitorit | komplet | 1.00 | 1694.92 | 18.00 | 2000.00 | 1694.92 | 305.08 | 2000.00 |
| **1.3** | Piketimi i trasës gjeodezike, sipas elementeve të trasës në profilin gjatësorë dhe tërthorazi në distancë në mesë profilev 25m', | m' | 4,188.00 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 7098.31 | 1277.69 | 8376.00 |
| | | | | | | | **10,488.14** | **1,887.86** | **12,376.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2** | **PUNET E PASTRIMIT DHE GËRMIT** | | | | | | | | |
| **2.1** | Pastrimi i terrenit, zbulimi i trasës, prerja e trupëzave, drunjëve të ndryshëm, shkurrave, me dimensione të ndryshme dhe të gjithë materialit të ndryshëm të hedhur në terren. Paguhet sipas m² të sipërfaqes së pastruar. Në çmim të llogaritet pastrimi dhe bartja deri në vendin ecaktuarë nga investitori | m² | 10,470.00 | 4.24 | 18.00 | 5.00 | 44364.41 | 7985.59 | 52350.00 |
| **2.2** | Gërmimi I dheut , ngarkimi , trasport , planifikimi, ngjeshja për ndërtimin e argjinatuareve me dimensione me ato egzistus, gërmimi do të bëhet në mbrendin në mesë të dy argjinaturave , mbushja do të bëhet me shtesa qëdo 50 cm të ngjeshët me ngjëshës iriq me peshë 8-12t | m³ | 22,025.25 | 4.24 | 18.00 | 5.00 | 93327.33 | 16798.92 | 110126.25 |
| **2.3** | Furnizimi me materjal zhavorë I lumit 0-60mm e rrugve lokale ng atë dy anët e kanlit , kjo rruge eshte e destinuarë për shfertezim të bujqve për qasjen në tokat bujqësore në këtë pozcionë [ërfshet planifimi I ternit , mbushja me zhavor , ngjeshj a 40Mpa me trashesi t=20cm , | m³ | 6,700.80 | 8.47 | 18.00 | 10.00 | 56786.44 | 10221.56 | 67008.00 |
| **2.4** | Gërmimi I kalit kullues në forme trapezi me dimensione thellesi H=1.5-2.0m . Matejali I gërmuarë t ë ngarkohet dhe transportohet në vendin e caktaure ng a org. mbikqyrës | m' | 8,376.00 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 14196.61 | 2555.39 | 16752.00 |
| **2.5** | Furnizimi me materjal dhe mbjellja e barit në siperfaqën e argjinaturave,farat duhet të jetë I përshtatëshum kushteve atmosferike.1kg/40m² | m² | 502,560.00 | 0.04 | 18.00 | 0.05 | 21294.92 | 3833.08 | 25128.00 |
| **2.6** | Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathte, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencen e ujit. | m' | 615.00 | 16.95 | 18.00 | 20.00 | 10423.73 | 1876.27 | 12300.00 |
| **2.7** | Përdorimi i pompave për largim të ujrave gjatë kryerjes së punëve ndertimore (sipas nevojës). | koplet | 1.00 | 423.73 | 18.00 | 500.00 | 423.73 | 76.27 | 500.00 |
| | | | | | | | **240,817.16** | **43,347.09** | **284,164.25** |

| 3 | PUNËT E DHEUT | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.1 | Germimi dhe gërryerja e materialeve te lumit, mbeturinave në lumë si dhe heqja e shtresës jo mbajtëse në përbërje të humusit. | $m^3$ | 77,145.60 | 2.54 | 18.00 | 3.00 | 196132.88 | 35303.92 | 231436.80 |
| 3.2 | Germimi I argjiles (mbushjes ) gjerë ne kuoten e caktuara dhe deponimi I perkohshem i saj ku te cakton organi mbikqyrës, kthimi ne trupin e lumit dhe shfrytezimi I saje per planifikimin final. | $m^3$ | 109,000.00 | 2.80 | 18.00 | 3.30 | 304830.51 | 54869.49 | 359700.00 |
| 3.3 | Gërmi , transporti dhe mbushja me dhe për krijimin e argjinaturave të lumit si nga terreni ekzistues deri te muri mbrojtës i shtratit të rregulluar. Mbushja duhet të bëhet me dheun e sjellur nga deponia me material të përshtatshëm për këtë qëllim. Sjellja e dheut nga deponia të cilën e cakton organi mbikëqyrës. Në çmim duhet të llogaritet: gropimi në deponi, tansporti deri në trasë, planifikimi, ngjeshja e dheut në shtresa 30cm deri në trusninë natyrale (nëse duhet edhe të laget me ujë). | $m^3$ | 151,500.00 | 2.97 | 18.00 | 3.50 | 449364.41 | 80885.59 | 530250.00 |
| 3.4 | Mbushja me dhe te kualitetit te pare per finalizimin e siperfaqeve te komplet shtratit te lumit | $m^3$ | 18,138.40 | 2.97 | 18.00 | 3.50 | 53800.34 | 9684.06 | 63484.40 |
| 3.5 | Planifikimi I dheut në sipërfaqën në thellësi h=0.55m', materjali I gërmuarë të ngarkohet dhe transportohet ne vendin e caktuar për krijimin e hapsirës së rë për qëllimin e zgjërimit të hapsirës së gjelbruarë | $m^3$ | 99,761.20 | 2.54 | 18.00 | 3.00 | 253630.17 | 45653.43 | 299283.60 |
| 3.6 | Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës simbas shtresave percjellese. | $m^2$ | 180,400.00 | 1.44 | 18.00 | 1.70 | 259898.31 | 46781.69 | 306680.00 |
| 3.7 | Largimi I dheut te tepert dhe barja e tije te caktohe nga organi mbikqyers deri ne largesi 10km. | $m^3$ | 122.00 | 4.24 | 18.00 | 5.00 | 516.95 | 93.05 | 610.00 |
| 3.8 | Nivelizimi, I siperfaqeve nga shtrati I rregulluar deri ne siperfaqet jasht bankinave. | $m^2$ | 328,000.00 | 0.25 | 18.00 | 0.30 | 83389.83 | 15010.17 | 98400.00 |
| | | | | | | | **1,601,563.39** | **288,281.41** | **1,889,844.80** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | PUNET E MURATIMIT ME GURË NATYRAL DHE BETONIMI I THMELEV DH E TRAJVE | | | | | | | | |
| 4.1 | Planifikimi I ternit në pjertësin në këndin e caktaurë nga 45' dhe sipas pozitës në pjesët e cakuara në tern | m² | 6,050.00 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 5127.12 | 922.88 | 6050.00 |
| 4.2 | furnizimi shtrirja dhe planifikimi I gjetekstilit mbi sipërfaqën e terenit të planifikuarë | m² | 6,655.00 | 0.42 | 18.00 | 0.50 | 2819.92 | 507.58 | 3327.50 |
| 4.3 | Furnizimi, ngarkimi trasporti dhe muratimi I mureve me llaq -beton MB25/30 me gurë gelqeror e me dimensione 40cm -60cm,në këtë pozcionë të përfshihet edhe mbushja e fugave me llac cimetos | m³ | 6,000.00 | 19.92 | 18.00 | 23.50 | 119491.53 | 21508.47 | 141000.00 |
| 4.4 | Furnizimi me materjal dhe betonimi I mureve të betonit me dimensione 0.45x1.0 | m³ | 485.10 | 127.12 | 18.00 | 150.00 | 61665.25 | 11099.75 | 72765.00 |
| 4.5 | Furnizimi , lakimi , dhe armimi I trajve dhe thmeleve armatore Ø6, Ø12 | kg | 29,106.00 | 1.10 | 18.00 | 1.30 | 32065.93 | 5771.87 | 37837.80 |
| 4.6 | Furnizimi, kallupimi dhe betonimi me MB30/37 trajve | m³ | 172.80 | 135.59 | 18.00 | 160.00 | 23430.51 | 4217.49 | 27648.00 |
| 4.7 | Furnizimi ,bushja dhe ngjeshja me zhavorr fraksion 0-31.5 mm me trashesi t=5c cm | m³ | 272.25 | 11.02 | 18.00 | 13.00 | 2999.36 | 539.89 | 3539.25 |
| 4.8 | Furnizimi me materjal dhe punimi I kokave shkrkuse të ujrave nga betoni I armuarë , në këtë pozcionë të përfshihen përgaditja ,bazamentev dhe mureve nga betoni I armuare ,armatura sipas udhzimeve të mbikqyrsit të 80kg/m³ | m³ | 102.00 | 101.69 | 18.00 | 120.00 | 10372.88 | 1867.12 | 12240.00 |
| | | | | | | | **257,972.50** | **46,435.05** | **304,407.55** |
| 5 | **PJESA E SIPËRME E LUMIT** | | | | | | | | |
| 5.1 | Furnizimi transporti punimi i ballorës së argjinaturës me gure natyror me trashesi deri ne 20 -60 cm sipas detaleve,Në çmim të llogariten komplet m²(ne qmim te parashihet, matjet gjeodezike pergjate bregut minor simbas niveletes se projektuar, planifimi +-2cm, dhe sigurimi ne veper i komplet pjeses siperfaqesore te mveshur me gure me materiale. | m² | 2,293.20 | 21.19 | 18.00 | 25.00 | 48584.75 | 8745.25 | 57330.00 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.2 | Furnizimi me matrieal zhavor 0-60 me trashesi 20 cm dhe dimensione b= 4m , te behet planifikimi dhe ngjeshja pargjate gjithe rruges e cila shfrytezohet per nevojat e tokave bujqesore | m³ | 8,810.10 | 8.39 | 18.00 | 9.90 | 73915.25 | 13304.74 | 87219.99 |
| 5.3 | Planifikimi I terenet dhe siperfaqeve jasht lumit si dhe mbjellja e barit ,mbjellja të bëhet 1kg\40m², në këtë pozcionë të përfshihën , lavrimi , frezimi dhe mbjellja dhe ngjeshja m e valak 120kg ( mjete bujqësore për ngjeshje dhe rrafshim ) | m² | 143,500.00 | 0.09 | 18.00 | 0.11 | 13377.12 | 2407.88 | 15785.00 |
| | | | | | | | 135,877.11 | 24,457.88 | 160,334.99 |

## R E K A P I T U L I M I

| Nr. | Përshkrimi | Vlera me TVSH në € |
|---|---|---|
| 1 | PUNËT PËRGATITORE | 12,376.00 |
| 2 | PUNET E PASTRIMIT DHE GËRMIT | 284,164.25 |
| 3 | PUNËT E DHEUT | 1,889,844.80 |
| 4 | PUNET E MURATIMIT ME GURË NATYRAL DHE BETONIMI I THMELEV DH E TRAJVE | 304,407.55 |
| 5 | PJESA E SIPËRME E LUMIT | 160,334.99 |
| | TOTALI I PËRGJITHSHËM = | **2,246,718.30** |
| | TVSH= | **404,409.29** |
| | TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH = : | **2,651,127.59** |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| EMRI I OE: | Asfalt Corp shpk |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Visar Qorolli |
| NËNSHKRIMI: | |
| DATA: | 05.06.2026 |
| VULA: | |

+383-(0)- 49 244 330
+383-(0)- 48 234 007
shpkelbau@gmail.com

ELBAU
Për një rrugë më të mirë

KOMPANIA EL BAU SH.P.K.

Rr. Limon Staneci
60000 Gjilan,
Republika e Kosovës

Në bazë të kritereve kualifikuese të përmbajtjes së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë sipas Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik (Verzioni i Konsoliduar) si dhe Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik dhe kornizën tjetër ligjore adekuate në fuqi, Kompania "EL-BAU" Sh.p.k. përmes personit përgjegjës të saj, nxjerr këtë:

# V E N D I M

**I punësuari z. SHABAN PLLANA, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë,**

**CAKTOHET** në detyrën Menaxher i Projektit për aktivitetin e prokurimit si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Titulli i aktivitetit: | " Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim " |
| Numri i prokurimit: | 644-26-3512-5-1-1 |
| Autoriteti Kontraktues: | Komuna e Vushtrrisë |

1. Menaxheri i projektit obligohet që në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të bëjë administrimin dhe menaxhimin e projektit në të gjitha fazat sipas standardeve të ndërtimtarisë në mënyrë që ekzekutimi i kontratës të përmbushet sipas performancës në përputhje me kushtet termat dhe referencat e specifikuar në kontratë; të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë si dhe efikasitetit maksimal të punimeve sipas planit dinamik të punimeve; të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës; të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të puneve në bazë të kushteve të kontratës si dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore, në rast se kompania **"El-Bau" Sh.p.k. shpërblehet me kontratë.**

2. Këtij vendimi i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës i inxhinierit në fjalë siç janë: *diploma, kontrata e punës, CV-ja, referencat me të cilat dëshmohet përvoja e punës profesionale të kërkuar.*

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e marrjes dhe nënshkrimit të tij.

Gjilan, dt. 03.06.2026

Vendimin e pranoi:

SHABAN PLLANA
I punësuar në "El Bau" Sh.p.k.

vula

Vendimin e morri:

Fatlum Pireva
Drejtor i El Bau Sh.p.k.

Kopje e këtij vendimi t'i dorëzohet:

1. *Të emëruarit z. Shaban Pllana;*
2. *Aministratës të kompanisë "El Bau" Sh.p.k.*

# Aneksi - 6.1

# AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE

**Për: Komuna e Vushtrrisë**
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

**Në emër të: [*Asfalt Corp shpk*]**
(në vazhdim "tenderuesi")

**Titulli i aktivitetit të prokurimit: Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic**

**Numri i Prokurimit: 644-26-3512-5-1-1**

## Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të projektit dhe Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriter i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE, DEKLRAROJMË se do të përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

**I.PERIUDHA GARANTUESE** për këtë projekt vlen :

1 (Nje) vite nga data e pranimit të përkohshëm të projektit
Shëno numrin e viteve
nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.

**Visar Qorolli**

______________________________

Emri i përfaqësuesit të OE

______________________________

Nënshkrimi

(Vula: SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA ASFALT Corp. sh.p.k. FERIZAJ)

## Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:

1. Ne të gjithë anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

2. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

3. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është [ Asfalt Corp SHPK ]

4. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

5. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës është;
   *a)* [*70%* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës *se Liderit Asfalt Corp shpk* ]
   *b)* [*25%* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës *e anëtarit Famis CO-HC sh.a*]
   *c)* [*5%* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës *e anëtarit EL-BAU SHPK*]

FAMIS CO HOLDING COMPANY SUHAREKË 04

6. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:
   *a)* *[Lideri i gupit - Udheheq ne projekt ne te gjitha fazat dhe me shumicen e kapaciteteve]*
   *b)* *[Antari 1- Mbeshtesin projektin dhe Liderin me kapacitete sipas nevojes]*
   c) *[Antari II- Mbeshtet projektin dhe Liderin me kapacitete sipas nevojes]*

7. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

8. Ne të gjithë anëtarët e grupit pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me anëtarin e mbetur, nëse anëtari i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

| | |
|---|---|
| Emri i Operatorit Ekonomik ( lider ) | Asfalt CorpSHPK |
| Emri Mbiemri | z.Visar Qorolli |
| Data / Nënshkrimi / Vula | 01.06.2026 |

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA ASFALT Corp. sh.p.k. FERIZAJ

# DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT

Për: **KOMUNA E VUSHTRRISË**

Në emër të: **GOE- ASFALT Corp SHPK & Famis CO - HC SH.A.& EL-BAU SHPK**

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim**

Numri i Prokurimit: **644-26-3512-5-1-1**

Hyjnë ne bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull: **Rregullimi i Lumit Silnica nga shkarkimin i lumit Podronqa deri te shkarkimi i lumit te fshatit Smrekonic-ritenderim** me numër te prokurimit **644-26-3512-5-1-1**

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

I. Asfalt Corp shpk me adresë:Ferizaj, me numër unik: 811915802, përfaqësuar nga z.Visar Qorolli- Pronar

II. Famis CO-HC SH.A.me adresë:Suharekë,me numër unik:810628399,përfaqësuar nga Fadil Bytyçi drejtor Menaxhues

III. EL-BAU SHPK me adresë: Gjilan, me numër unik: 811182576, përfaqësuar nga drejtori Fatlum Pireva

Datë: [01.06.2026]

Vendi [Ferizaj ]

Anëtaret e tjerë te grupit:

| | |
|---|---|
| Emri i Operatorit Ekonomik | Famis CO-HC sh.a |
| Emri Mbiemri | Fadil Bytyçi |
| Data / Nënshkrimi / Vula | 01.06.2026 |

Anëtaret e tjerë te grupit:

| | |
|---|---|
| Emri i Operatorit Ekonomik | EL-BAU SHPK |
| Emri Mbiemri | Fatlum Pireva |
| Data / Nënshkrimi / Vula | 01.06.2026 |

Asfalt Corp SHPK - z.Visar Qorolli ( Përfaqësuesi i autorizuar )

Data/Nënshkrimi / Vula 01.06.2026

## AUTORITETI KONTRAKTUES

**KOMUNA E VUSHTRRISË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,**

**Zyrtari përgjegjes i prokurimit:**

**Nr i Prokurimit: 644-26-3512-5-1-1**

## OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik ASFALT Corp. SH.P.K.; Famis CO - HC SH.A.; EL-BAU SH.P.K., Ferizaj, 70000, Ferizaj, Kosovë**

E-mail: **v_qorolli@hotmail.com**

Personi kontaktues: **Visar Qorolli**

Telefoni: **049944244**

Faxi:

Numri fiskal:

**Grup i operatorëve ekonomik** (nëse aplikohet):

Partneri **1.**

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë: | **EL-BAU SH.P.K.** |
| Numri fiskal: | **811182576** |
| Vend-Selia: | **LIMON STANECI P.N., -, GJILAN, Kosovë** |

Partneri **2.**

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë: | **Famis CO - HC SH.A.** |
| Numri fiskal: | **810628399** |
| Vend-Selia: | **Magjistralja Suharekë - Prizren, nr.205, 23000, SUHAREKË, Kosovë** |

Partneri **3.**

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë: | **ASFALT Corp. SH.P.K.** |
| Numri fiskal: | **811915802** |
| Vend-Selia: | **Ferizaj, 70000, Ferizaj, Kosovë** |